| 7 | Islam Adem Llozi | 372/4 | 3346 | 1250 | 259 | 323750 | Proces Regjistrimi |
| 8 | Ismail Abdyl Llozi | 374/5 | 3346 | 574 | 259 | 148666 | Proces Regjistrimi |
| 9 | Qazim Hasan Llozi | 380/4 | 3346 | 674 | 259 | 174566 | Proces Regjistrimi |
| 10 | Zeqir Selim Llozi | 318/2 | 3346 | 680 | 259 | 176120 | Proces Regjistrimi |
| 11 | Zeqir Selim Llozi | 370/2 | 3346 | 1750 | 259 | 453250 | Proces Regjistrimi |
| 12 | Ali Tahir Hasa | 382/4 | 3346 | 1672 | 259 | 433048 | Proces Regjistrimi |
| 13 | Ali Tahir Hasa | 383 | 3346 | 1000 | 259 | 259000 | Proces Regjistrimi |
| 14 | Ali Tahir Hasa | 384 | 3346 | 62 | 259 | 16058 | Proces Regjistrimi |
| 15 | Zeqir Tahir Hasa | 384/1 | 3346 | 547 | 259 | 141673 | Proces Regjistrimi |
| | **TOTALI** | | | **14881** | | **3854179** | |

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË PREKEN PËR EFEKTIN E NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS UNAZA E RE E TIRANËS - ELBASAN
LOTI III-të (DALJE TUNEL- km 29+275)

| Nr. | PRONARI<br>Emri, atësia, mbiemri | Nr. i pasurisë | Zona kadastrale | TOKË/ARË<br>Sip ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| | **SHIJON Z.K.3371** | | | | | | |
| | | | | | | | |
| 1 | Aroland Peter Terziu | 5\12 | 3371 | 230 | 496 | 114080 | Proces regjistrimi |
| 2 | Agim Peter Terziu | 5\11 | 3371 | 515 | 496 | 255440 | Proces regjistrimi |
| 3 | Jani Preni | 5\9 | 3371 | 1153 | 496 | 571888 | Proces regjistrimi |
| 4 | Vladimir Toli | 5\8 | 3371 | 816 | 496 | 404736 | Proces regjistrimi |
| 5 | Thoma Toli | 5\7 | 3371 | 459 | 496 | 227664 | Proces regjistrimi |
| 6 | Kristaq Vladimir Toli | 5\6 | 3371 | 327 | 496 | 162192 | Proces regjistrimi |
| 7 | Spiro Sifi Preni | 5\3 | 3371 | 351 | 496 | 174096 | Proces regjistrimi |
| 8 | Dhespina Ranxha | 5\2 | 3371 | 592 | 496 | 293632 | Proces regjistrimi |
| 9 | Ilia Jani Ranxha | 9\23 | 3371 | 469 | 496 | 232624 | Proces regjistrimi |
| 10 | Agim Jorgji Ranxha | 9\21 | 3371 | 566 | 496 | 280736 | Proces regjistrimi |
| 11 | Dhimiter Thanas Gega | 9\20 | 3371 | 699 | 496 | 346704 | Proces regjistrimi |
| 12 | Mark Mihal Ranxha | 9\19 | 3371 | 788 | 496 | 390848 | Proces regjistrimi |
| 13 | Sifi Spiro Ranxha | 9\18 | 3371 | 512 | 496 | 253952 | Proces regjistrimi |
| 14 | Avram Jorgji Gjika | 9\17 | 3371 | 1082 | 496 | 536672 | Proces regjistrimi |
| 15 | Simon Kole Doko | 9\16 | 3371 | 1025 | 496 | 508400 | Proces regjistrimi |
| 16 | Vladimir Mihal Preni | 9\15 | 3371 | 585 | 496 | 290160 | Proces regjistrimi |
| 17 | Ligor Jorgji Gjika | 9\13 | 3371 | 609 | 496 | 302064 | Proces regjistrimi |
| 18 | Petri Kole Doka | 11\37 | 3371 | 66 | 496 | 32736 | Proces regjistrimi |
| 19 | Anastas Sifi Preni | 11\36 | 3371 | 587 | 496 | 291152 | Proces regjistrimi |
| 20 | Vasil Preni | 11/36/1 | 3371 | 286 | 496 | 141856 | Proces regjistrimi |
| 21 | Peter Terziu | 11\33 | 3371 | 755 | 496 | 374480 | Proces regjistrimi |
| 22 | Agim Jorgji Gjika | 11\20 | 3371 | 1112 | 496 | 551552 | Proces regjistrimi |
| 23 | Ligor Anastas Ranxha | 11\18 | 3371 | 353 | 496 | 175088 | Proces regjistrimi dhe saktësimi |
| 24 | Jorgji Ranxha | 11\8 | 3371 | 288 | 496 | 142848 | Proces regjistrimi |
| 25 | Vasil Spiro Toli | 36/31 | 3371 | 260 | 496 | 128960 | Proces regjistrimi dhe saktësimi |
| 26 | Josif Ilia Terziu | 36/27 | 3371 | 1214 | 496 | 602144 | Proces regjistrimi |
| 27 | Ilia Petraq Toli | 36/26 | 3371 | 825 | 496 | 409200 | Proces regjistrimi |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | Petraq Toli | 36/25 | 3371 | 866 | 496 | 429536 | Proces regjistrimi |
| 29 | Jani Anastas Gega | 36/24 | 3371 | 865 | 496 | 429040 | Proces regjistrimi |
| 30 | Ilia Anastas Gega | 36/23 | 3371 | 821 | 496 | 407216 | Proces regjistrimi |
| 31 | Vasil Jani Hala | 36/22 | 3371 | 856 | 496 | 424576 | Proces regjistrimi |
| 32 | Jani Petri Hala | 36/21 | 3371 | 986 | 496 | 489056 | Proces regjistrimi |
| 33 | Stravri Doka | 36/20 | 3371 | 748 | 496 | 371008 | Proces regjistrimi dhe saktësimi |
| 34 | Sokrat Spiro Toli | 36/17 | 3371 | 997 | 496 | 494512 | Proces regjistrimi |
| 35 | Jovan Dhimiter Toli | 36/14 | 3371 | 829 | 496 | 411184 | Proces regjistrimi |
| 36 | Vladimir Filip Preni | 36/12 | 3371 | 917 | 496 | 454832 | Proces regjistrimi |
| 37 | Jani Gega | 38/14 | 3371 | 2293 | 496 | 1137328 | Proces regjistrimi |
| 38 | Kostandin Jorgji Gega | 38/1 | 3371 | 403 | 496 | 199888 | Proces regjistrimi dhe saktësimi |
| | **TOTALI** | | | **27105** | | **13444080** | |

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË PREKEN PËR EFEKTIN E NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS UNAZA E RE E TIRANËS - ELBASAN
LOTI III-të (DALJE TUNEL- km 29+275)

| **Nr.** | **PRONARI** Emri, atësia, mbiemri | **Nr. i pasurisë** | **Zona kadastrale** | **TOKE ARË** Sip ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | **Shënime** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| | **SHTEMAJ 3419** | | | | | | |
| | | | | | | | |
| 1 | Ibrahim Meta | 238/6 | 3419 | 1500 | 296 | 444000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 2 | Adile Myzyri | 103/1 | 3419 | 78 | 296 | 23088 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 3 | Sabri Allhasa | 104/1 | 3419 | 500 | 296 | 148000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 4 | Musa Allhasa | 104/3 | 3419 | 709 | 296 | 209864 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 5 | Musa Allhasa | 107/1 | 3419 | 538 | 296 | 159248 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 6 | Qerim Allhasa | 105/1 | 3419 | 482 | 296 | 142672 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 7 | Riza Sala | 107/2 | 3419 | 702 | 296 | 207792 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 8 | Nazmi Allhasa | 105/4 | 3419 | 1291 | 296 | 382136 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 9 | Qerim Allhasa | 106/6 | 3419 | 927 | 296 | 274392 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 10 | Zylyf Allhasa | 106/5 | 3419 | 300 | 296 | 88800 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 11 | Riza Sula | 106/2 | 3419 | 189 | 296 | 55944 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 12 | Jonuz Sula | 107/3 | 3419 | 500 | 296 | 148000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Qazim Allhasa | 111/1 | 3419 | 1000 | 296 | 296000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 14 | Qazim Allhasa (trshg) | 111/17 | 3419 | 990 | 296 | 293040 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 15 | Shaqir Sula | 111/7 | 3419 | 500 | 296 | 148000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 16 | Riza Sula | 111/8 | 3419 | 500 | 296 | 148000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 17 | Enver Meta | 111/14 | 3419 | 85 | 296 | 25160 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 18 | Shaqir Allhasa (trshg) | 111/12 | 3419 | 1000 | 296 | 296000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 19 | Ramazan Meta | 111/15 | 3419 | 467 | 296 | 138232 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 20 | Sadik Meta | 111/13 | 3419 | 1000 | 296 | 296000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 21 | Ramazan Meta | 111/16 | 3419 | 841 | 296 | 248936 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 22 | Sabri Kalem Allhasa | 123/3 | 3419 | 2000 | 296 | 592000 | Proces Regjistrimi |
| 23 | Qazim Allhasa | 123/5 | 3419 | 2000 | 296 | 592000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 24 | Nazmi Allhasa | 110/1 | 3419 | 606 | 296 | 179376 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 25 | Sulejman Allhasa | 111/2 | 3419 | 500 | 296 | 148000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 26 | Ismail Sula | 111/3 | 3419 | 700 | 296 | 207200 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 27 | Shaqir Allhasa (trshg) | 110/2 | 3419 | 200 | 296 | 59200 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 28 | Rrapush Myzyri | 111/5 | 3419 | 128 | 296 | 37888 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 29 | Ismail Sula | 111/10 | 3419 | 232 | 296 | 68672 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 30 | Ardian Myzyri | 111/19 | 3419 | 142 | 296 | 42032 | Proces Regjistrimi |
| 31 | Sabri Kalem Allhasa | 111/11 | 3419 | 923 | 296 | 273208 | Proces Regjistrimi |
| 32 | Qamil Allhasa (trshg) | 111/18 | 3419 | 1490 | 296 | 441040 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 33 | Ramazan Meta | 123/2 | 3419 | 190 | 296 | 56240 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 34 | Xhemal Myzyri | 125/1 | 3419 | 1000 | 296 | 296000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 35 | Muhamet Myzyri | 125/2 | 3419 | 2000 | 296 | 592000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 36 | Bashkim Hasa | 125/3 | 3449 | 1000 | 296 | 296000 | Proces regjistrimi |
| 37 | Nezir Meta | 136/7 | 3419 | 1390 | 296 | 411440 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 38 | Muhamet Myzyri | 127/1 | 3419 | 236 | 296 | 69856 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 39 | Xhemal Myzyri | 127/2 | 3419 | 1200 | 296 | 355200 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 40 | Ibrahim Meta | 136/6 | 3419 | 1500 | 296 | 444000 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 41 | Sali Kusi | 136/4 | 3419 | 418 | 296 | 123728 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| | **TOTALI** | | | **31954** | | **9458384** | |

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË PREKEN PËR EFEKTIN E NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS UNAZA E RE E TIRANËS - ELBASAN
LOTI III-të (DALJE TUNEL- km 29+275)

| Nr. | PRONARI Emri, atësia, mbiemri | Numri i pasurisë | Zona kadastrale | TOKË ARË Sip ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | TOKËARË Sip ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Vlera totale lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | |
| | **ULEM Z.K.3674** | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| 1 | Hyqmet Karaj | 82/3 | 3674 | 213 | 359 | 76467 | | | | 76467 | Proces regjistrimi dhe verifikimi |
| 2 | Ismail Jonuz Cani | 61/1 | 3674 | 321 | 359 | 115239 | | | | 115239 | Proces Regjistrimi dhe saktësimi |
| 3 | Mahmut Osman Cani | 61/3 | 3674 | 381 | 359 | 136779 | | | | 136779 | Proces regjistrimi |
| 4 | Selman Zyber Karaj | 62/3 | 3674 | 595 | 359 | 213605 | | | | 213605 | Proces regjistrimi |
| 5 | Osman Nezir Sula | 68/1 | 3674 | 1500 | 359 | 538500 | | | | 538500 | Proces regjistrimi |
| 6 | Medi Sula | 52/2 | 3674 | 319 | 359 | 114521 | | | | 114521 | Proces regjistrimi |
| 7 | Agim Sula | 69/3 | 3674 | 336 | 359 | 120624 | | | | 120624 | Proces regjistrimi |
| 8 | Ali Jonuz Sula | 69/4 | 3674 | 500 | 359 | 179500 | | | | 179500 | Proces regjistrimi |
| 9 | Osman Nezir Sula | 69/8 | 3674 | 1000 | 359 | 359000 | 176 | 667 | 117392 | 476392 | Proces regjistrimi dhe verifikimi |
| 10 | Shefqet Arif Sula | 69/10 | 3674 | 488 | 359 | 175192 | | | | 175192 | Proces regjistrimi |
| 11 | Bajram Rrapush Sula | 69/14 | 3674 | 580 | 359 | 208220 | | | | 208220 | Proces regjistrimi |
| 12 | Hamit Mustafa Meta | 82/4 | 3674 | 548 | 359 | 196732 | | | | 196732 | Proces regjistrimi |
| 13 | Ruzhdi Halil Sula | 79/21 | 3674 | 1717 | 359 | 616403 | | | | 616403 | Proces regjistrimi |
| | **TOTALI** | | | **8498** | | **3050782** | **176** | | **117392** | **3168174** | |

**URDHËR**
**Nr. 105, datë 23.3.2012**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ETIKËN NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE DHE BOTUESE"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 63 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese", bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe institucionet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
**Myqerem Tafaj**

**RREGULLORE**
PËR ETIKËN NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE DHE BOTUESE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. PËRKUFIZIME

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1 "Kërkimi shkencor" quhet puna krijuese e ndërmarrë dhe e realizuar në mënyrë sistematike, që ka për qëllim shtimin dhe zhvillimin e njohurive shkencore.

1.2 "Kërkimi themelor" quhet puna origjinale teorike dhe/ose eksperimentale e ndërmarrë, për përftimin e njohurive të reja, pa pasur pikësynim të drejtpërdrejtë ndonjë zbatim ose përdorim praktik të saj. Ky lloj i kërkimit, që e përfshin veprimtarinë kërkimore, dallohet nga kërkimi i zbatuar.

1.3 "Kërkimi i zbatuar" quhet puna origjinale kërkimore e ndërmarrë për të zgjidhur problemet specifike të përdorimit praktik. Dallohet nga kërkimi themelor, sepse nuk synon përftimin apo prodhimin e njohurive të reja të përgjithshme.

1.4 "Zhvillimi eksperimental" quhet puna sistematike e mbështetur mbi njohuritë ekzistuese të fituara nga kërkimi themelor apo i zbatuar dhe mbi të dhënat shkencore, e orientuar drejt prodhimit të produkteve apo të pajisjeve të reja dhe që ka për qëllim njohjen, studimin, zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

1.5 "Kërkim-zhvillimi" (K-ZH) quhet veprimtaria e ndërmarrë në mënyrë sistematike që synon shtimin e tërësisë së njohurive, duke përfshirë edhe ato për njeriun, kulturën dhe shoqërinë, si edhe përdorimin e dobishëm të tyre. Ajo ka në përbërje të saj kërkimin themelor, kërkimin e zbatuar dhe zhvillimin eksperimental, në përputhje me përcaktimet e bëra më sipër.

1.6 "Veprimtari kërkimore" quhet kërkimi logjik dhe sistematik i informacioneve të reja dhe të dobishme me synim gjetjen e përgjigjeve për pyetjet që lindin dhe të zgjidhjeve të problemeve në fusha të ndryshme të shkencës nëpërmjet analizave objektive dhe përdorimit të metodologjisë së duhur shkencore.

1.7 "Institucion kërkimor" quhet institucioni i arsimit të lartë, qendra kërkimore apo instituti ku zhvillohet veprimtari kërkimore shkencore.

2. VEPRIMTARITË JOSHKENCORE

Kërkimi joshkencor është një mënyrë e fitimit të dijeve e njohurive që rrjedhin nga besimi, traditat dhe dijet joshkencore. Veprimtaritë që nuk përfshihen në K-ZH, përmblidhen si më poshtë:

2.1 Arsimimi dhe trajnimi, që përfshin të gjitha veprimtaritë arsimore, formuese dhe aftësuese të personelit në shkencat natyrore, inxhinierike, mjekësi, bujqësi, shkencat shoqërore dhe humanitare në institucionet e arsimit të lartë, të passhkollës së mesme, pa përfshirë këtu K-ZH e kryer nga studentët e ciklit të dytë dhe të tretë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2.2 Veprimtaritë e tjera teknologjike, të specifikuara, si: mbledhje, kodim regjistrim, klasifikim, përhapje e njohurive, përkthim, analizë, vlerësim të kryera nga personeli shkencor dhe/apo teknik, personeli i bibliotekave etj.

2.3 Veprimtaritë e tjera industriale dhe veprimtaritë teknike të lidhura me të. Me prodhim dhe veprimtari teknike të lidhura me të, kuptohet paraprodhimi industrial, prodhimi dhe shpërndarja e mallrave dhe e shërbimeve duke përfshirë këtu edhe veprimtaritë e përafërta, të cilat organizohen në disiplina të tilla që parashikojnë studimin e tregut.

2.4 Administrimi dhe veprimtaritë e tjera mbështetëse, përmblidhen në dy komponentë:

2.4.1 veprimtaritë financuese të K-ZH;

2.4.2 veprimtaritë ndihmëse.

K-Zh efektiv arrihet nëpërmjet zhvillimit të kulturës së përparuar kërkimore të kërkuesve shkencorë dhe institucioneve kërkimore.

3. KULTURA KËRKIMORE

Kultura kërkimore kërkon:

3.1 Nivel të lartë shkencor (ekselencë)

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor synojnë arritjen e një niveli të lartë kërkimi dhe përhapjen me cilësi të rezultateve të tij.

3.2 Ndershmëri

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor punojnë për krijimin, përhapjen dhe ruajtjen e kulturës së kërkimit, duke respektuar parimin e ndershmërisë në kërkim. Liria dhe ndershmëria në punën kërkimore garanton saktësinë e të dhënave dhe të rezultateve të kërkimit.

3.3 Kompetencë dhe integritet

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor vënë në zbatim kompetencat dhe njohuritë e tyre brenda fushës ku kryhet veprimtaria kërkimore dhe mbështeten në metoda e teknika, për të cilat kanë përgatitjen e duhur shkencore dhe të përditësuar, si edhe përvojën e nevojshme praktike.

Drejtuesi i kërkimit shkencor të jetë i kualifikuar profesionalisht, të ketë titull akademik ose gradë shkencore dhe të karakterizohet nga integriteti shkencor.

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor zhvillojnë veprimtari kërkimore në përputhje me kornizën ligjore dhe etike të fushës në të cilën kryhet ajo. Ata deklarojnë çdo konflikt të mundshëm apo real interesi në raport me objektin apo fushën e kërkimit dhe marrin masat për zgjidhjen e tij.

3.4 Kujdes për kafshët dhe mjedisin që janë pjesë e veprimtarisë kërkimore

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor, që kryejnë eksperimente apo prova shkencore me mjedisin apo me qeniet e gjalla, të cilat mund të dëmtohen gjatë këtyre eksperimenteve, marrin një aprovim etik paraprak, nënshkruajnë marrëveshje me specialistë të fushës apo institucione të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e tyre dhe ndërmarrin një fushatë informuese e transparente.

3.5 Miradministrim të burimeve të përdorura për kërkimin shkencor

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor veprojnë në transparencë të plotë, për publikun e gjerë dhe garantojnë kryerjen e veprimtarisë kërkimore në përputhje me parimet e miradministrimit të burimeve të përdorura.

3.6 Komunikim dhe bashkëpunim

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor sigurojnë shkëmbimin e lirë të ideve, të metodave të kërkimit dhe të rezultateve të tij.

3.7 Përgjegjshmëri sociale

Kërkuesi shkencor apo institucioni kërkimor janë të përgjegjshëm në përdorimin e teorive dhe metodave, mbi të cilat mbështeten. Kërkuesi shkencor, që kryen veprimtari kërkimore në kuadër të ushtrimit të profesionit të rregulluar, e zhvillon atë brenda kuadrit ligjor dhe etik të profesionit të rregulluar në fjalë, të përcaktuar në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3.8 Siguri

Kërkuesi shkencor, njësia apo institucioni kërkimor garantojnë sigurinë, dinjitetin, të drejtat e pjesëmarrësve apo objektit të kërkimit, evitojnë rreziqe ose dëmtime të paarsyeshme të subjekteve të kërkimit dhe raportojnë e informojnë për çdo shqetësim lidhur me to.

3.9 Formim dhe aftësim

Institucioni kërkimor ofron mundësi formimi për personat që kryejnë veprimtari kërkimore me pikësynim aftësimin e tyre për të arritur standardet e kërkuara dhe i mbështesin ata në identifikimin e nevojave lidhur me këtë proces.

Kërkuesi shkencor shfrytëzon burimet e nevojshme për të bërë kërkim individual ose brenda një grupi kërkimor në bashkëpunim me specialistë të njohur të fushës së kërkimit dhe raporton për punën kërkimore të kryer.

## KREU II
## PARIMET DHE PRAKTIKAT PËR INKURAJIMIN E VEPRIMTARISË KËRKIMORE

1. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE

Kërkimi shkencor efektiv pasqyron shkallën e zhvillimit të kulturës kërkimore të institucionit.

Përgjegjësitë e institucionit

1.1 Nxitja e veprimtarisë kërkimore efektive

Institucioni duhet:

1.1.1 të nxitë ndërgjegjësimin për të gjitha aktet ligjore e nënligjore të kërkimit shkencor;

1.1.2 të hartojë dokumente, që përcaktojnë qartë politikat dhe procedurat e bazuara në këtë rregullore;

1.1.3 të nxitë vazhdimisht bashkëpunimin e ndërsjellë midis kërkuesve nëpërmjet shkëmbimit të hapur të ideve dhe respektimit të lirisë së shprehjes;

1.1.4 të ruajë një klimë që nxit përgjegjshmëri dhe etikë në kërkim.

1.2 Krijimi i praktikave pozitive drejtuese dhe menaxhuese

Institucioni përfshin në strategjinë e kërkimit dhe të zhvillimit të tij, praktikat pozitive të kërkimit të përmendura në këtë rregullore.

1.2.1 Institucioni harton një kuadër të qartë rregullues për etikën në kërkim dhe integritetin shkencor që ka të bëjë me praktikat pozitive nëpërmjet të cilave kërkimi vlerësohet për cilësinë, sigurinë, ruajtjen e anonimitetit, menaxhimin e riskut, menaxhimin financiar dhe respektimin e etikës. Kuadri drejtues parashikon:

a) mbrojtjen e personave;

b) deklarimin e detyrueshëm të veprimtarisë kërkimore që kryhet në institucion;

c) trajtimin e rasteve të veprimeve të ndëshkueshme dhe të mungesës së etikës në kërkim;

ç) menaxhimin e konfliktit të interesit;

d) menaxhimin financiar dhe koston e projekteve e të veprimtarisë kërkimore;

dh) menaxhimin e bazës së të dhënave dhe dosjeve kërkimore;

e) funksionimin e një komiteti të etikës në kërkim.

1.2.2 Institucioni zbaton kuadrin rregullues në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë zhvillimin e kërkimit shkencor në vend dhe përmbush detyrimet kontraktuale që lindin nga nënshkrimi i marrëveshjeve mes palëve;

1.2.3 Institucioni siguron disponueshmërinë e dokumenteve që ndihmojnë drejtimin, zhvillimin dhe menaxhimin e kërkimit shkencor;

1.2.4 Institucioni ndjek një politikë të qartë për hartimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore në bashkëpunim me organizma të tjerë shkencorë, e cila kërkon arritjen e marrëveshjeve para fillimit të zbatimit të projektit. Marrëveshjet mbulojnë aspektet e menaxhimit financiar, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, të drejtën e autorësisë, respektimin e origjinalitetit krijues (shmangien e plagjiaturës) dhe sigurimin e botimit dhe shpërndarjes së rezultateve të kërkimit shkencor, miratimin paraprak etik dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

1.2.5 Institucioni ndjek një procedurë të mirëpërcaktuar për pranimin dhe menaxhimin e ankesave për veprime të ndëshkueshme në kërkim. Institucioni kërkimor merr masa për mospërsëritjen e tyre;

1.2.6 Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë kërkimore të tij;

1.2.7 Institucioni synon dhe nxit rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe krijimin e traditave në kërkim.

1.3 Trajnimi i personelit për etikën në kërkim

Institucioni parashikon aktivitete trajnuese të vazhdueshme për pjesëmarrësit në kërkim, për personelin mësimor kërkimor, madje edhe për studentët. Në këto aktivitete trajnuese që mund të jenë konferenca, seminare apo ditë informimi ofrohet informacion për metodat e kërkimit, etikën në kërkim, konfidencialitetin, drejtimin e kërkimit, ruajtjen e të dhënave. Institucioni ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje për trajnime të përbashkëta me institucione të tjera.

1.4 Këshillimi i kërkuesit shkencor për praktikat pozitive në kërkim

Institucioni këshillon kërkuesin shkencor dhe mbikëqyr efektivitetin e veprimtarisë së tij kërkimore. Ky proces përfshin këshillimin për etikën kërkimore, hartimin e projekteve, metodat kërkimore dhe zhvillimin e një kërkimi të përgjegjshëm.

1.5 Garantimi i një mjedisi kërkimor të sigurt

Institucioni garanton një mjedis pune të sigurt në të cilin zhvillohet veprimtaria kërkimore.

Përgjegjësitë e kërkuesit:

1.6 Ruajtja e standardeve të larta të kërkimit shkencor të përgjegjshëm

Kërkuesi karakterizohet nga ndershmëria intelektuale, integriteti dhe saktësia shkencore. Ai duhet:

1.6.1 të njohë përgjegjësitë e tij gjatë kërkimit;

1.6.2 të respektojë të drejtat e atyre që preken nga kërkimet e tij;

1.6.3 të shmangë konfliktin e interesit;

1.6.4 të përdorë metoda të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë kërkimore;

1.6.5 të ndjekë praktikat e duhura për mbrojtjen dhe sigurinë;

1.6.6 të raportojë çmime a diploma të fituara dhe punime kërkimore, duke përfshirë edhe ato që janë në proces recensimi ose botimi, që ndihmojnë veprimtarinë kërkimore në fjalë;

1.6.7 të zbatojë këtë rregullore në përputhje me politikat e miratuara nga institucioni i tij dhe organet e financimit të kërkimit.

1.7 Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore

Kërkuesi shkencor bën publike me përgjegjësi, rezultatet e veprimtarisë kërkimore.

1.8 Respektimi i integritetit dhe konfidencialitetit të pjesëmarrësve në veprimtarinë kërkimore

Kërkuesi respekton integritetin dhe konfidencialitetin e pjesëmarrësve, në veprimtarinë kërkimore. Përdorimi i të dhënave personale të pjesëmarrësve në veprimtarinë kërkimore bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

1.9 Respektimi i legjislacionit për mbrojtjen e kafshëve në veprimtarinë kërkimore

Kërkuesi shkencor respekton legjislacionin në fuqi dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara për mbrojtjen e kafshëve që përdoren për eksperimente gjatë kërkimit shkencor.

1.10 Respektimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit

Kërkuesi shkencor gjatë veprimtarisë kërkimore respekton kufizimet e shfrytëzimit të mjedisit për qëllime kërkimore dhe siguron shmangien e dëmtimit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

1.11 Raportimi i veprimeve të ndëshkueshme në kërkimin shkencor

Kërkuesi shkencor, që konstaton një praktikë negative në kërkim raporton në kohën e duhur, duke pasur parasysh politikat e institucionit dhe paraqet në mënyrë të vazhdueshme propozime për përmirësime në organizimin dhe zbatimin e praktikave pozitive në kërkim.

2. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I VEPRIMTARISË KËRKIMORE

Institucioni vlerëson veprimtarinë kërkimore të kryer nga kërkuesit shkencorë, jo vetëm për të matur përparimin e tyre në karrierën akademike, por edhe efikasitetin e fondeve të përdorura për kërkim në funksion të përmirësimit të politikave të kërkimit.

Institucioni kërkimor parashikon në politikat e tij ruajtjen e të dhënave dhe rezultateve të veprimtarisë kërkimore, si edhe të drejtën e konsultimit të tyre nga studiuesit e interesuar.

Përgjegjësitë e institucionit

2.1 Për vlerësimin e veprimtarisë shkencore institucioni mbështetet në komunikimin e rezultateve të kërkimit, në vazhdimësinë e veprimtarisë kërkimore të bazuar në këto rezultate dhe njohjen e ecurisë së veprimtarisë kërkimore nga pjesa tjetër e komunitetit shkencor.

2.1.1 Institucioni kërkimor monitoron veprimtarinë kërkimore, në afate kohore të përcaktuara në përputhje me veçoritë e saj, duke respektuar legjislacionin në fuqi;

2.1.2 Institucioni kërkimor vlerëson veprimtarinë kërkimore, në afate kohore të përcaktuara në përputhje me veçoritë e saj, duke respektuar legjislacionin në fuqi;

2.1.3 Institucioni kërkimor ngre grupe pune ose komisione për kryerjen e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit të veprimtarisë kërkimore;

2.1.4 Institucioni kërkimor trajnon grupet e punës për kryerjen procesit të monitorimit dhe vlerësimit lidhur me problemet e etikës, ndershmërisë, plagjiaturës, etj.;

2.1.5 Institucioni kërkimor monitoron veprimtarinë kërkimore që në momentin e përcaktimit të metodave të kërkimit e deri pas përfundimit të saj.

2.2 Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave në veprimtarinë kërkimore

Mbledhja e të dhënave është grumbullimi i tyre nga kërkuesi gjatë fazës së parë të veprimtarisë kërkimore duke treguar kujdes për saktësinë e tyre që do t'i shërbejë rezultatit final, ndërsa ruajtja e tyre është procesi që ndodh pas përfundimit të saj deri në afatin e parashikuar nga institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.2.1 Institucioni harton një politikë për mbledhjen dhe ruajtjen e materialeve dhe të dhënave të kërkimit. Politikat institucionale hartohen në përputhje me praktikat pozitive të disiplinës përkatëse, në të cilën zhvillohet veprimtaria kërkimore dhe me legjislacionin në fuqi;

2.2.2 Të dhënat e kërkimit digjitalizohen dhe ruhen në bazën e të dhënave të institucionit. Për raste të veçanta, periudha për ruajtjen e të dhënave përcaktohet nga specifika e fushës së kërkimit, si:

a) për projekte kërkimore afatshkurtra që shërbejnë vetëm për qëllime vlerësimi, të tilla si projektet kërkimore të zhvilluara nga ana e studentëve, të dhënat kërkimore ruhen deri në 12 muaj pas përfundimit të projektit;

b) për shumicën e provave klinike, ruajtja e të dhënave kërkimore bëhet në përputhje me ligjin nr. 7815, datë 20.4.1994 "Për barnat", e ndryshuar;

c) për fusha të tilla si terapia gjenetike, të dhënat e kërkimit ruhen gjithmonë (p.sh. të dhënat e pacientit).

2.3 Krijimi i bazës së të dhënave të veprimtarisë kërkimore

2.3.1 Institucioni krijon bazën elektronike të të dhënave të veprimtarisë kërkimore ku ruhen rezultatet e kërkimit. Baza e të dhënave të veprimtarisë kërkimore ngrihet në nivel institucioni ose njësie përbërëse;

2.3.2 Institucioni krijon mjedise të sigurta për ruajtjen e të dhënave të veprimtarisë kërkimore;

2.3.3 Institucioni harton politika të qarta për ruajtjen e të dhënave, edhe për rastet kur:

a) kërkuesi lëviz nga një institucion në tjetrin brenda vendit;

b) të dhënat janë mbledhur jashtë vendit etj.

2.4 Mbrojtja e së drejtës së autorit në veprimtarinë kërkimore

Institucioni parashikon në politikat e veta të drejtat dhe kufizimet mbi pronësinë e produkteve që

janë objekt i zbatimit të projekteve kërkimore dhe mbi të dhënat gjatë dhe pas këtij procesi në mbështetje të ligjit nr. 7574, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit", të ndryshuar, të vendimit nr. 760, datë 1.9.2010 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale dhe Industriale, 2010-2015", si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2.5 Institucioni kërkimor ndjek një politikë të qartë për ruajtjen e pronësisë intelektuale dhe për mundësinë e konsultimit të bazës së të dhënave.

2.5.1 Institucioni monitoron zbatimin e kësaj politike për menaxhimin e të dhënave të veprimtarisë kërkimore dhe materialeve parësore, duke përfshirë mundësinë e aksesimit të tyre, por edhe ruajtjen e pronësisë dhe konfidencialitetit;

2.5.2 Institucioni informon kërkuesin shkencor në lidhje me marrëveshjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me konfidencialitetin dhe kufizimet për përdorimin e të dhënave të kërkimit;

2.5.3 Institucioni vë në dispozicion sisteme kompjuterike të sigurta dhe garanton sigurinë e rrjetit dhe kontrollin e të drejtave të hyrjes në to;

2.5.4 Institucioni garanton sigurinë e materialeve parësore, ku përfshihen edhe materialet elektronike duke parashikuar gjithashtu të drejtat dhe kufizimet në aksesimin e tyre.

Përgjegjësitë e kërkuesit shkencor

Kërkuesi shkencor tregon gatishmëri për monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë kërkimore që drejton apo në të cilën merr pjesë. Kërkuesi shkencor bashkëpunon me monitoruesit dhe vlerësuesit gjatë këtyre proceseve.

2.6 Ruajtja e të dhënave të veprimtarisë kërkimore dhe materialeve parësore

2.6.1 Kërkuesi ruan të dhënat e veprimtarisë kërkimore dhe materialet parësore për një kohë të mjaftueshme që lejon referimin ndaj tyre nga kërkues të tjerë dhe nga palët e interesuara. Të dhënat e veprimtarisë kërkimore që janë bërë publike, ruhen përgjithmonë në formë të digjitalizuar;

2.6.2 Kërkuesi, në rastet e kontestimeve të rezultateve të veprimtarisë kërkimore, ruan materialet e përfshira në këtë proces deri në argumentimin dhe zgjidhjen e çështjes;

2.6.3 Kërkuesi shkencor zbaton politikat institucionale për asgjësimin e sigurt të materialeve parësore të veprimtarisë kërkimore.

2.7 Menaxhimi i të dhënave të veprimtarisë kërkimore dhe materialeve parësore

Kërkuesi shkencor menaxhon të dhënat e veprimtarisë kërkimore dhe materialet parësore, në përputhje me politikat e institucionit. Me përfundimin e projektit kërkimor, kërkuesi shkencor dorëzon në institucion një kopje të bazës së të dhënave të kërkimit dhe të rezultateve të kërkimit, si dhe të materialeve parësore. Për të arritur këtë, ai duhet:

2.7.1 të mbajë shënime të qarta dhe të sakta për metodat e kërkimit dhe burimet e të dhënave, duke përfshirë çdo miratim të dhënë, gjatë dhe pas procesit të kërkimit;

2.7.2 të ruajë rezultatet e veprimtarisë kërkimore dhe materialet parësore sipas afatit të përcaktuar ligjor;

2.7.3 të sigurojë të njëjtin nivel të kujdesit dhe të mbrojtjes së të dhënave parësore të veprimtarisë kërkimore të tilla si: fletoret e laboratorit dhe të dhënat e analizuara të kërkimit;

2.7.4 të ruajë të dhënat e veprimtarisë kërkimore, duke përfshirë të dhënat elektronike, në një formë të qëndrueshme, të indeksuar dhe të aksesueshme nga kërkuesit e interesuar;

2.7.5 të menaxhojë të dhënat e veprimtarisë kërkimore dhe materialet parësore në përputhje me etikën dhe legjislacionin përkatës.

2.8 Ruajtja e konfidencialitetit

Kërkuesi, ruan konfidencialitetin e të dhënave të veprimtarisë kërkimore dhe të materialeve parësore.

3. UDHËHEQJA E KËRKUESVE TË RINJ

Kërkuesit e rinj fillimisht informohen në lidhje me respektimin e etikës në kërkim, respektimin e kësaj rregulloreje dhe politikat e institucioneve kërkimore. Udhëheqësit e tyre sigurohen që kolegëve më të rinj t'u paraqesin një model pozitiv dhe ndihmës për arritjen e një niveli të lartë kulture në këtë fushë, me integritet të plotë dhe profesionalizëm. Kërkuesit e rinj të jenë të vetëdijshëm që kryerja e veprimtarisë kërkimore është një sipërmarrje e madhe, e cila kërkon përkushtim dhe përgjegjësi.

Përgjegjësitë e institucionit

3.1 Shtimi i numrit të kërkuesve shkencorë

3.1.1 Institucioni kërkimor ndjek një politikë të qartë për të shtuar numrin e kërkuesve shkencorë;

3.1.2 Institucioni u bën të njohur dhe u vë në dispozicion kërkuesve të rinj, dokumentacionin ekzistues në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë kërkimore, duke përfshirë këtë rregullore, udhëzimet institucionale për kryerjen e veprimtarisë kërkimore, informacionin për të drejtat dhe kufizimet ndaj objekteve të kërkimit dhe respektimin e parimeve kryesore nga të cilat duhet të udhëhiqen gjatë kryerjes së saj.

3.2 Sigurimi i standardeve në udhëheqje

Institucionet përgjegjëse sigurojnë që secili nga kërkuesit, qoftë ai personel akademik i atij institucioni ose jo, do të ketë një mbikëqyrës të kualifikuar dhe të trajnuar. Përcaktohet një raport i përshtatshëm i numrit të kërkuesve që do të drejtohen nga një udhëheqës/mbikëqyrës për të siguruar efektivitet në rezultatet e veprimtarisë kërkimore, sipas legjislacionit në fuqi.

Përgjegjësitë e udhëheqësit

3.3 Sigurimi i trajnimit

Udhëheqësi trajnon dhe informon kërkuesin e ri për mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave me metodat e reja kërkimore, të komunikimit dhe të bashkëveprimit me komunitete të ndryshme apo partnerë nga fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë.

3.4 Drejtimi i kërkuesit dhe sigurimi i mbështetjes

Udhëheqësi drejton e monitoron zhvillimin profesional të kërkuesve të rinj.

3.5 Sigurimi i kërkimit cilësor dhe me vlera

Udhëheqja përfshin edhe mbikëqyrjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore nga udhëheqësit. Udhëheqësi sigurohet për saktësinë e metodave kërkimore mbi të cilat mbështetet kërkuesi gjatë veprimtarisë kërkimore dhe për saktësinë e rezultateve të nxjerra nga ai nën mbikëqyrjen e tij. Ai është përgjegjës për vlefshmërinë dhe saktësinë e rezultateve të arritura nga kërkuesi që udhëheq.

Përgjegjësitë e kërkuesit shkencor

3.6 Bashkëpunimi me udhëheqësin

Kërkuesi i ri mban qëndrim të drejtë profesional gjatë veprimtarisë kërkimore. Kërkuesi shkencor konsultohet me udhëheqësin për të dhënat e mbledhura, mënyrën se si i ka përpunuar dhe analizuar ato, si edhe për rezultatet e kërkimit.

3.7 Pjesëmarrja në trajnime

Kërkuesi i ri merr pjesë në aktivitetet trajnuese para fillimit të veprimtarisë kërkimore. Ai i kërkon udhëheqësit ta informojë në lidhje me metodat e reja mbi të cilat do ta mbështesë veprimtarinë kërkimore.

4. PUBLIKIMI I REZULTATEVE TË VEPRIMTARISË KËRKIMORE

Veprimtaria kërkimore ka për qëllim prodhimin dhe shtimin e njohurive kërkimore. Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore bëhet në forma të ndryshme: revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, vëllime me përmbledhje të referimeve, kumtesave të mbajtura në kuadër të një veprimtarie shkencore (simpozium, konferencë, kongres), monografi etj. Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore është një hallkë mjaft e rëndësishme e procesit kërkimor, që e bën të njohur kërkuesin në gjirin e komunitetit shkencor dhe i mundëson atij përmirësimin e kësaj veprimtarie duke e bërë atë të vlefshme për kërkuesit e tjerë dhe për mbarë komunitetin shkencor.

Përgjegjësitë e institucionit

4.1 Publikimi i punimeve cilësore

Institucioni publikon rezultatet e veprimtarisë kërkimore të zhvilluar në një mjedis, ku mbizotëron integriteti, besueshmëria dhe përgjegjësia.

4.2 Mbrojtja e konfidencialitetit dhe respektimi i së drejtës mbi pronësinë intelektuale

4.2.1 Institucioni garanton vetëdijesimin e palëve pjesëmarrëse në kërkim për të drejtat dhe kufijtë e informimit në lidhje me të dhënat konfidenciale;

4.2.2 Institucioni ndjek një politikë e cila mbron të drejtat e pronësisë intelektuale të institucionit, kërkuesit dhe financuesit të veprimtarisë kërkimore;

4.2.3 Institucioni garanton, nëpërmjet financuesve të veprimtarisë kërkimore publikimin në kohë e me cilësi të rezultateve të saj dhe informon kërkuesin, në rast të vonesave e pengesave në lidhje me publikimin.

4.3 Publikimi *online* i rezultateve të veprimtarisë kërkimore

4.3.1 Institucioni publikon në faqen zyrtare të institucionit në format të pamanipulueshëm përmbledhjet e referimeve shkencore të mbajtura në konferenca, brenda dhe jashtë vendit nga kërkuesit që ushtrojnë veprimtarinë kërkimore pranë tij;

4.3.2 Institucioni publikon në faqen zyrtare të institucionit në format të pamanipulueshëm artikujt shkencorë të publikuar në revista shkencore, brenda dhe jashtë vendit nga kërkuesit që ushtrojnë veprimtarinë kërkimore pranë tij;

4.3.3 Institucioni publikon në faqen zyrtare të institucionit në format të pamanipulueshëm disertacionet e hartuara dhe të paraqitura për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, si dhe tezat e paraqitura për marrjen e diplomës “Master i shkencave”;

4.3.4 Institucioni parashikon në politikat e veta edhe rastin e publikimeve paraprake të punimeve të kërkuesve, të cilat vetë autorët e tyre zgjedhin t’i vendosin menjëherë në dispozicion të komunitetit shkencor, duke i publikuar *online* në faqen zyrtare të institucionit ku ata ushtrojnë veprimtarinë kërkimore, edhe pse ato nuk kanë marrë ende formën përfundimtare.

4.4 Transparenca e financimit të veprimtarisë kërkimore

Institucioni bën transparente organizmat financues të veprimtarisë kërkimore dhe mënyrën se si janë fituar e menaxhuar projektet kërkimore nga kërkuesit apo grupet kërkimore.

Përgjegjësitë e kërkuesit shkencor

4.5 Vënia në dispozicion e rezultateve të veprimtarisë kërkimore.

Kërkuesi shkencor ka detyrimin dhe përgjegjësinë për të bërë publike të plotë përmbledhjen e veprimtarisë kërkimore.

4.5.1 Kërkuesi vë në dispozicion për publikim përmbledhjet e referimeve shkencore të mbajtura në konferenca, brenda dhe jashtë vendit;

4.5.2 Kërkuesi vë në dispozicion për publikim artikujt shkencorë të publikuar në revista shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Procesi i publikimit të marrë në konsideratë çdo kufizim në lidhje me pronësinë intelektuale ose të dhënat konfidenciale;

4.5.3 Kërkuesi vë në dispozicion për publikim disertacionin e paraqitur në provimin për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”.

4.6 Përgjegjësia e komunikimit të rezultateve të kërkimit shkencor në publik

Sipas kushteve të vëna nga financuesi i kërkimit shkencor, kërkuesi i komunikon rezultatet e kërkimit në një audiencë të gjerë që përfshin financuesin, organizatat profesionale, politikëbërësit ose komunitetin e gjerë. Kërkuesi gëzon të drejtën të intervistohet në media, të ftohet në debate, në seminare dhe veprimtari të tjera ku jepet ndihmë profesionale, për komunikimin me median dhe komunitetin e gjerë, etj.

Gjatë komunikimit publik të rezultateve të kërkimit shkencor respektohen pikat e mëposhtme:

4.6.1 Rezultatet e kërkimit nuk bëhen publike pa kaluar vlerësimin (recensën) në grup. Gjatë diskutimit të rezultateve të kërkimit të një projektpropozimi, përmendet statusi i projektpropozimit, në qoftë se ai është në proces apo ka përfunduar;

4.6.2 Për të minimizuar keqkuptimet që lidhen me rezultatet e kërkimit, kërkuesi ua komunikon ato palëve të interesuara, përpara publikimit të tyre për publikun e gjerë;

4.6.3 Rezultatet e kërkimit që janë objekt i marrëdhënieve tregtare, vlerësohen nga një organ financiar përpara se të bëhen publike;

4.6.4 Për komunikimin e të dhënave dhe publikimin e tyre duhen mbajtur parasysh marrëveshjet mes kërkuesit dhe financuesit të kërkimit.

4.7 Sigurimi i saktësisë së publikimit dhe përhapjes së informacionit

Kërkuesi sigurohet që veprimtaria kërkimore që vë në dispozicion për publikim të jetë e saktë dhe e mirëraportuar.

4.8 Shmangia e plagjiaturës

Kërkuesi është i detyruar të citojë në mënyrë të plotë e të saktë autorët dhe punimet e tyre, të cilat i ka konsultuar si burime të para apo burime dytësore dhe i ka përdorur për t'u informuar në lidhje me rezultatet e mëparshme apo për të argumentuar dhe interpretuar rezultatet e veprimtarisë kërkimore.

4.9 Shmangia e përdorimeve të shumëfishta të të dhënave dhe të rezultateve të veprimtarisë kërkimore

Kërkuesi nuk duhet të paraqesë të njëjtat arritje shkencore në disa publikime dhe as publikime të ngjashme pa vënë në dukje përmirësimet apo ndryshimet nga publikimet e mëparshme.

4.10 Marrja e lejes për ribotim

Kërkuesi respekton kriteret dhe rregullat e përcaktuara nga institucioni kërkimor dhe ai botues, në rastet kur do të ribotojë rezultatet e veprimtarisë kërkimore.

4.11 Transparenca e financimit të veprimtarisë kërkimore

Në publikim jepet informacion për burimet e mbështetjes financiare dhe çdo konflikt të mundshëm interesi. Kërkuesi shpreh mirënjohjen për institucionin pritës dhe institucionin që mundëson financimin e veprimtarisë kërkimore.

4.12 Respektimi i etikës në lidhje me kryerjen, përdorimin dhe ruajtjen e provave klinike

Kërkuesi respekton parimet e etikës në lidhje me provat klinike (studim sistematik në njerëz, me qëllim që të zbulohen a verifikohen efektet terapeutike dhe/ose efektet anësore të produkteve mjekësore, si dhe të studiohen përthithja, shpërndarja, metabolizmi ose jashtëqitja e një bari, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimet farmaceutike", të ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.

4.13 Regjistrimi i provave klinike

Kërkuesi regjistron studimet klinike dhe provat klinike të arritura në përfundim të tyre në regjistra të caktuar për këtë qëllim, si edhe të aksesueshëm *online*.

5. AUTORËSIA

Përhapja e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore realizohet në mënyra të ndryshme, por format më të qëndrueshme janë artikujt në revista shkencore, ku kërkuesi shkencor konsolidon emrin dhe pozitat e tij. Për t'u cilësuar si autor, kërkuesi jep një kontribut të rëndësishëm në kërkim dhe është i gatshëm të mbajë përgjegjësi për pjesën e punimeve në të cilat ka dhënë kontribut. Roli i tij është i pazëvendësueshëm dhe është një investim intelektual themelor për hartimin e punimeve shkencore, për arritjen dhe përhapjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore dhe për komunitetin shkencor. Hartimi i një artikulli shkencor kërkon angazhimin serioz të autorit jo vetëm në lidhje me shkrimin e rileximin e materialit, por mbi të gjitha punën kërkimore për mbledhjen e informacionit, verifikimin dhe citimin e burimeve të tij, etj.

Autorësia, në varësi të specifikës së disiplinës shkencore, bazohet në kontributet thelbësore që janë kombinimi i konceptimit, hartimit e zbatimit të një projekti dhe analizës së interpretimit të të dhënave e të rezultateve të veprimtarisë kërkimore. Hartimit të pjesëve të rëndësishme të punës dhe rishikimit kritik të tyre duke përfshirë interpretimin.

Përgjegjësitë e institucionit

5.1 Garantimi i së drejtës për të botuar dhe përhapur rezultatet e veprimtarisë kërkimore

Institucioni garanton botimin dhe përhapjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të kërkuesve që e ushtrojnë këtë veprimtari pranë dhe në kuadër të institucionit.

5.2 Koordinimi i punës mes financuesit të veprimtarisë kërkimore dhe kërkuesit

Institucioni garanton raporte korrekte mes financuesit të veprimtarisë kërkimore dhe kërkuesit në lidhje me publikimin e rezultateve të punës kërkimore. Ai parandalon ndikimin e financuesit në paraqitjen dhe interpretimin e rezultateve.

5.3 Respektimi i kritereve të autorësisë

Institucionet ndjekin një politikë të qartë lidhur me kriteret e autorësisë, ku përfshihen edhe

mënyrat e trajtimit të rasteve kur ka kontradikta për autorësinë. Në rastet kur puna kërkimore përfshin disa autorë, autori kryesor mban korrespodencën me botuesin.

5.4 Zbulimi i plagjiaturës

Institucionet që kryejnë veprimtari kërkimore sigurojnë *software* që kontrollojnë në mënyrë automatike për plagjiaturë punimet kërkimore dhe botimet (kumtesa, referate, artikuj shkencorë, disertacione, monografi, tekste mësimore, manuale, teza të paraqitura për marrjen e diplomës “Master i shkencave”).

Përgjegjësitë e kërkuesit shkencor

5.5 Respektimi i politikave në lidhje me autorësinë

Kërkuesi u përmbahet kritereve për autorësinë dhe politikave institucionale në lidhje me të.

5.6 Rënia dakord për autorësinë

Kërkuesit që bashkëpunojnë bien dakord për autorësinë e një publikimi në një fazë të hershme të veprimtarisë kërkimore dhe rishikojnë vendimet e tyre periodikisht.

5.7 Përfshirja e të gjithë kontribuesve

Autorësinë e marrin ata kërkues shkencorë të angazhuar në kërkim, të cilët kanë dhënë kontribut të dukshëm dhe janë të gatshëm të mbajnë përgjegjësi për punimin shkencor.

5.8 Moslejimi i përfshirjes së pamerituar në autorësi

Asnjë nga kontributet e mëposhtme, në vetvete, nuk e justifikon përfshirjen e një personi në autorësi:

5.8.1 të qenit autoritet drejtues i njësisë apo institucionit dhe ushtrimi i autoritetit që ofron pozicionimi në këtë detyrë apo miqësia personale me autorët;

5.8.2 dhënia e një ndihme teknike, por pa ndonjë pjesëmarrje konkrete në punim;

5.8.3 angazhimi për sigurimin dhe përdorimin efikas të fondeve apo mbikëqyrja formale e kërkuesve;

5.8.4 sigurimi i burimeve dytësore të informacionit.

5.9 Shprehja e mirënjohjes ndaj kontribuesve në kërkim

Kërkuesi citon të gjithë ata që kanë kontribuar në punën kërkimore nëpërmjet vënies në dispozicion të mjediseve për kryerjen e veprimtarisë kërkimore, të pajisjeve laboratorike, etj. Në rast të një vlerësimi specifik me citim të emrit, merret paraprakisht edhe miratimi me shkrim.

6. VLERËSIMI I PUNIMEVE SHKENCORE (*REVIEW*)

Termi “*peer review*” përdoret për të cilësuar vlerësimin e pavarur dhe të paanshëm të kërkimit nga kërkues të tjerë të së njëjtës fushë. Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore është një procedurë e përdorur nga vetë institucioni apo nga organizmat që financojnë veprimtarinë kërkimore të tij për të matur efikasitetin e këtij financimi në funksion të efektivitetit të veprimtarisë kërkimore. Vlerësimi bazohet në disa tregues që kanë të bëjnë me: komunikimin e rezultateve të veprimtarisë kërkimore, vijimësinë e veprimtarisë kërkimore që sigurohet nga këto rezultate, njohjen e këtyre rezultateve nga pjesa tjetër e komunitetit shkencor dhe reklamimin e këtyre rezultateve.

Vlerësimi merr parasysh ekspertizën e bërë për çështje të ndryshme dhe ndikimin e tyre në veprimtarinë kërkimore. Ndihmon në ruajtjen e standardeve të larta, si dhe në raportimin e saktë, të plotë dhe të besueshëm të rezultateve të kërkimit. Vlerësimi shmang problemet që lidhen me botimet e dyfishta, deklaratat e pavërteta etj., megjithatë ai nuk siguron, i vetëm, integritetin e kërkimit.

Përgjegjësitë e institucionit

6.1 Inkurajimi i pjesëmarrjes në vlerësim

Institucioni inkurajon e mbështet kërkuesin të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të veprimtarisë krijuese kërkimore të kërkuesve të tjerë. Institucioni kërkon nga vlerësuesi të jetë objektiv dhe të ruajë konfidencialitetin. Ai garanton vlerësuesin për mungesën e presionit para, gjatë dhe pas procesit të vlerësimit të punimeve shkencore.

6.2 Angazhimi i grupeve të pavarura të vlerësimit

Institucioni angazhon grupe specialistësh që kanë njohuri shumë të mira nga veprimtaria në fushat përkatëse, të cilat respektojnë parimet e vlerësimit të pavarur dhe nuk ndikohen në asnjë rast nga rrethanat e jashtme.

Përgjegjësitë e vlerësuesit

6.3 Kryerja e vlerësimit me përgjegjshmëri

Është e rëndësishme që pjesëmarrësit në vlerësim të plotësojnë kushtet në vijim:

6.3.1 të jenë të ndershëm dhe të respektojnë afatet e vlerësimit;

6.3.2 të veprojnë në konfidencialitet të plotë dhe të mos ndërhyjnë në përmbajtjen e punimit shkencor;

6.3.3 të deklarojnë çdo konflikt interesi që përpara përfshirjes në vlerësim;

6.3.4 të respektojnë kriteret që aplikohen për vlerësim;

6.3.5 të mos pranojnë të përfshihen në një vlerësim që është jashtë fushës së tyre të ekspertizës;

6.3.6 të vlerësojnë punimet shkencore drejt, pa u ndikuar nga rrethanat e jashtme;

6.3.7 të depozitojnë me shkrim recensat për vlerësimin e punimeve, për të cilat janë ngarkuar të jenë vlerësues.

6.4 Sinjalizimi i veprimeve të ndëshkueshme

Vlerësuesit, të cilët gjatë procesit të vlerësimit konstatojnë shkelje të formës së plagjiaturës, kopjimit apo falsifikimit të të dhënave, ose shkelje të natyrës etike në konceptimin apo realizimin e punës kërkimore, informojnë, duke ruajtur konfidencialitetin, përfaqësuesin e organizmit që ka kërkuar vlerësimin (botuesin e revistës, këshillin e etikës, financuesin e projektit etj.).

6.5 Realizimi i trajnimeve për vlerësuesit

Drejtuesi kërkimor ka përgjegjësi të trajnojë kërkues për procesin e vlerësimit, që këta të fundit të fitojnë njohuritë e nevojshme për procesin e vlerësimit, si dhe të kuptojnë detyrimet që rrjedhin prej këtij procesi.

Përgjegjësitë e kërkuesit shkencor

6.6 Mosndërhyrja gjatë procesit të vlerësimit

Kërkuesi, puna e të cilit është duke kaluar në një proces vlerësimi, nuk ndërhyn gjatë këtij procesi.

7. KONFLIKTI I INTERESIT

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet interesave individuale të një personi dhe përgjegjësive profesionale në të cilën ai ka interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij në veprimtarinë shkencore.

Institucioni ndjek një politikë të qartë për shmangien e konfliktit të interesit.

Përgjegjësitë e institucionit

7.1 Përcaktimi i një politike të qartë

Institucioni ndjek një politikë të caktuar për menaxhimin e konfliktit të interesit. Kjo politikë përmban një gamë përgjigjesh, në përputhje me natyrën e konfliktit, me qëllim që të pengojë kërkuesit apo vlerësuesit e veprimtarisë kërkimore të influencojnë në mënyrë të padrejtë në vendime dhe të evitojë perceptimin e pajustifikuar që një konflikt interesi nuk është marrë në konsideratë.

Politika e hartuar nga institucioni duhet:

7.1.1 t'u bëhet e qartë të gjithë kërkuesve;

7.1.2 në rastet e konstatimit të konfliktit të interesit, të kërkohet një deklaratë e plotë nga personat e përfshirë për të paraqitur rrethanat që kanë çuar në konflikt interesi;

7.1.3 personi që është në konflikt interesi nuk merr pjesë në proceset vendimmarrëse;

7.1.4 në rastet e një konflikti të mundshëm apo real mbahet një procesverbal, i cili detajon mënyrën se si është menaxhuar ai. Në procesverbal nuk përfshihet informacion konfidencial;

7.1.5 politikat e institucionit parashikojnë menaxhimin e konfliktit të interesit në të gjitha rastet e mundshme dhe i rishikojnë ato periodikisht në funksion të përmirësimit të tyre.

Përgjegjësitë e kërkuesit shkencor

7.2 Të deklarojë konfliktin e interesit

Kërkuesi shkencor që është në kushtet e konfliktit të interesit apo përballet me raste të konfliktit të interesit duhet t'i deklarojë ato.

Kërkuesi shkencor përdor qasjet e mëposhtme, në raste të konfliktit të interesit:

7.2.1 zbaton politikat e institucionit;

7.1.2 në rast të angazhimit në grupet apo komitetet e vlerësimit të punimeve shkencore tërhiqet menjëherë;

7.2.3 deklaron në kohën e duhur dhe me përgjegjësi çdo konflikt, në dukje, të mundshëm apo faktik të interesit.

8. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL NË KËRKIMIN SHKENCOR

Kërkimi shkencor përfshin një gamë të gjerë bashkëpunimesh brenda institucioneve, ndërmjet institucioneve, si dhe ndërkombëtare.

Përgjegjësitë e institucionit

8.1 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit

Institucioni që përfshihet në veprimtarinë kërkimore nënshkruan marrëveshje me partnerët lidhur me menaxhimin e veprimtarisë kërkimore.

Marrëveshja parashikon respektimin e parimeve të përcaktuara në këtë rregullore, duke përfshirë integritetin në kërkim, ndershmërinë, angazhimin për ekselencë në kërkim, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, konfidencialitetit dhe të drejtën e autorit. Në nene të veçanta të saj mund të parashikohen institucionet që financojnë veprimtarinë kërkimore dhe të ardhurat që mund të sigurohen prej saj.

8.2 Menaxhimi i të drejtave mbi materialet parësore

Palët bashkëpunuese përcaktojnë personat përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar paraprakisht për menaxhimin e të dhënave, rezultateve të kërkimit apo dhe të materialeve parësore të veprimtarisë kërkimore.

Përgjegjësitë e kërkuesit shkencor

8.3 Respektimi i marrëveshjeve ndërinstitucionale

Kërkuesi shkencor i përfshirë në kërkime të përbashkëta është i vetëdijshëm për të gjitha politikat dhe marrëveshjet me shkrim që ndikojnë në veprimtarinë kërkimore, sidomos për ato që lidhen me publikimin e rezultateve të veprimtarisë kërkimore dhe menaxhimin e të dhënave parësore.

8.4 Deklarimi i konfliktit të interesit

Kur zhvillohen veprimtaritë kërkimore të përbashkëta, kërkuesi shkencor deklaron, nëse ka, konfliktin në dukje, të mundshëm ose faktik të interesit në lidhje me veprimtarinë kërkimore.

8.5 Pjesëmarrja në trajnime

Kërkuesi shkencor që zhvillon veprimtari kërkimore në kuadër të një marrëveshjeje trajnohet periodikisht për mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të veprimtarisë kërkimore.

## KREU III
## SHKELJE TË RREGULLORES, VEPRIME TË NDËSHKUESHME NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE DHE TRAJTIMI I TYRE

Institucioni, në rastet kur dyshon se kërkuesi nuk ka vepruar me korrektësi, ndërmerr këto hapa: hetim të fshehtë (diskret) dhe zyrtar; vendosje të një sanksioni; vepron për të përmirësuar situatën; këshillon grupet e ekspertëve dhe bën deklarata publike, sipas rastit. Për zgjidhjen e çështjes, nuk kërkohet kalimi nëpër të gjithë hapat e sipërcituar.

Kërkimi shkencor nuk konsiston në përdorimin e metodave absolutisht të pagabueshme dhe shkenca ushqehet vazhdimisht nga përpjekjet, pasiguritë dhe gabimet e kërkuesve shkencorë. Në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë kërkimore mund të ndodhë që çdo kërkues të kryejë me ose pa dashje apo të përballet me çështje të etikës profesionale a morale në kërkim.

1. SHKELJE TË RREGULLORES DHE VEPRIME TË NDËSHKUESHME NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE

Institucioni konsideron veprime të ndëshkueshme:

1.1 Fabrikimin e të dhënave, që quhet sajimi, prodhimi i të dhënave apo edhe i rezultateve të falsifikuara ose i aspekteve të tjera të veprimtarisë kërkimore duke përfshirë edhe ato për dokumentimin dhe aprovimin e pjesëmarrësve;

1.2 Mashtrimin shkencor, që është një veprim i ndëshkueshëm. Ai është i ndryshëm nga gabimi dhe përfshin:

1.2.1 Plagjiaturën: që quhet përvetësimi ose përdorimi i ideve, pronës intelektuale, apo punës së të tjerëve, në mënyrë të shkruar apo në mënyra të tjera, pa njoftimin dhe aprovimin e autorit;

1.2.2 Falsifikimin: që quhet ndryshimi me qëllim dhe/ose seleksionimi jo i drejtë i të dhënave, pamjeve dhe/ose dhënies së pëlqimit të bashkëpunëtorëve/bashkautorëve.

1.3 Interpretimin e gabuar: që quhet paraqitja e gabuar e të dhënave dhe përhapja e gabuar e rezultateve si: heqja, neglizhimi dhe interpretimi i gabuar me qëllim i të dhënave dhe/ose zbulimeve, si dhe kërkesa jo e argumentuar për përfshirje në autorësi apo mohimi i autorësisë.

1.4 Menaxhimin e gabuar apo ruajtjen e papërshtatshme të të dhënave dhe/apo materialeve parësore që kupton mosmbajtjen e shënimeve të qarta e të kujdesshme për procedurat dhe rezultatet e veprimtarisë kërkimore, si dhe pamundësinë e përdorimit nga të tjerët në periudha të caktuara pas përfundimit të kërkimit.

1.5 Cenimin e konfidencialitetit: dhënien e paautorizuar të informacioneve për të dhëna zyrtare të veprimtarisë kërkimore në proces.

1.6 Vendosjen në rrezik të pjesëmarrësve apo individëve, të përfshirë në veprimtarinë kërkimore apo cenimin e reputacionit të tyre, nëpërmjet neglizhimit të marrjes së masave të nevojshme mbrojtëse.

1.7 Vlerësimin jo të drejtë në recensat (*peer review*) e punimeve kërkimore dhe/apo rezultateve të saj (duke përfshirë dorëshkrimet e paraqitura për publikim).

2. PËRGJEGJËSITË

2.1 Përgjegjësinë për të zgjidhur rastet e identifikuara si veprime të ndëshkueshme e kanë:

2.1.1 Autoritetet drejtuese të njësisë kryesore dhe të institucionit;

2.1.2 Personi përgjegjës për vlerësimin paraprak të akuzave;

2.1.3 Këshilluesi për integritetin e kërkimit;

2.1.4 Drejtuesi i njësisë kërkimore (departamentit, grupit mësimor kërkimor);

2.1.5 Udhëheqësi i kërkuesit shkencor;

2.1.6 Kërkuesi shkencor.

2.2 Për raste të veçanta ose rastet kur institucioni nuk jep zgjidhje, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përgjegjësinë për zgjidhjen e tyre, si autoriteti më i lartë mbikëqyrës i veprimtarisë së institucionit kërkimor.

Përgjegjësitë në nivel institucional

2.3 Përcaktimi i politikave të qarta për trajtimin e ankesave

Institucioni përcakton në rregulloren e tij rastet e trajtimit të ankesave në lidhje me kërkimin shkencor. Në rregullore parashikohen masat që merren në rast të moszbatimit dhe shkeljes së kësaj rregulloreje.

2.4 Rishikimi i kontratës punëdhënës-punëmarrës

Çështjet që kanë të bëjnë me konstatimin e veprimeve të ndëshkueshme dhe trajtimin e tyre parashikohen në kontratat punëdhënës-punëmarrës, krahas trajtimit të formave të tjera të shkeljeve në punë.

Përgjegjësitë në nivel departamenti apo qendre kërkimore

Drejtuesi i departamentit dhe titullari i grupit mësimor kërkimor janë pika e parë e kontaktit, në rastin kur lindin shqetësime gjatë veprimtarisë kërkimore. Shkeljet e kësaj rregulloreje që nuk përbëjnë veprime të ndëshkueshme trajtohen në nivelin e departamentit.

3. E DREJTA E ANKIMIT

3.1 Kushdo që konstaton se kërkuesi shkencor ka vepruar në mënyrë të papërgjegjshme paraqet ankesën e tij në departamentin përkatës.

3.2 Ankesat, së pari, trajtohen në nivel departamenti, në përputhje me afatet dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

3.3 Ankimi pasi shqyrtohet në rrugë administrative, ndiqet në rrugë gjyqësore në përputhje me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, të ndryshuar.

**VENDIM**
**Nr. 34, datë 5.4.2012**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN POWER” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MARTANESH”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a” nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1 germa “a” dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.4.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Power” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Power” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Martanesh” me fuqi 10.5 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 35, datë 5.4.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "ALBANIAN POWER" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a" neneve 9 dhe 13 pika 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa "g" nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1 germa "a" dhe 3, të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.4.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 36, datë 5.4.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "ALBANIAN POWER" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR "HEC MARTANESH" SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa "d" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21 datë 18.03.2009, të ndryshuar dhe neneve 6, 7 dhe 8 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë

elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 5.4.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albanian Power" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues "Hec Martanesh", si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Albanian Power" sh.p.k. është konform "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme" si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , germat "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germa "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, germat "a", "b", "c"

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për "Hec Martanesh", si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 37, datë 5.4.2012**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË RISHIKUAR TË INVESTIMEVE TË "CEZ SHPËRNDARJE" SHA PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, nenit 10 të rregullores "Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.4.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të rishikuar të investimeve të "CEZ shpërndarje" sh.a. për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, si dhe në vijim të vendimmarrjes së saj nr. 143, datë 7.12.2011, për miratimin me kusht të planit të investimeve të "CEZ shpërndarje" sh.a. për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014,

konstatoi se:

Plani i rishikuar i investimeve të shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a. i paraqitur në ERE, pas vendimmarrjes me kusht, është përmirësuar mjaftueshëm si më poshtë:

- Nga pikëpamja e vlerave të investimeve të shpërndara sipas grupimeve konstatohet se përmirësohen raportet e investimeve sipas studimit për reduktimin e humbjeve.

- Në zërin investime në proces dallohet qartë tendenca e uljes së vlerave të mbartura për vitin pasardhës.

- Në zërin investime në nënstacione është reflektuar sugjerimi i ERE-s.

- Në zërin investime në matje është reflektuar sugjerimi për shtyrjen e investimeve në matësit me parapagesë dhe është planifikuar plotësimi i matjes në nënstacione dhe kabina.

- Zëri i investimeve prioritare është detajuar mjaftueshëm dhe dallohet tendenca për të kryer investime që tentojnë uljen e humbjeve dhe sigurinë e furnizimit.

Aplikimi i "CEZ shpërndarje" sh.a. për planin e rishikuar të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores "Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e rishikuar të investimeve të "CEZ shpërndarje" sh.a. për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 (Plani i investimeve bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e "CEZ shpërndarje" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 38, datë 5.4.2012**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HYDRO POWER PLANT OF KORÇA" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET "VERBA 1" DHE "VERBA 2"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a" nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a"; 5 pika 1 germa "a"; 13 dhe 14 pika 2 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.4.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hydro Power Plant of Korça" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hydro Power Plant of Korça" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hydro Power Plant of Korça" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et "Verba 1" me fuqi 2 MW dhe "Verba 2" me fuqi 3 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**KËRKESË**

Shtetasja Mirela Skënderi, e bija Haxhiut dhe e Bedries, e datëlindjes 13.5.1970, lindur në Krujë dhe banuese në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Fatmir Skënderi.

**Kërkuesja**
Mirela Skënderi

**KËRKESË**

Shtetasja Admira Bezo (Como), e bija e Rahmit dhe e Bardhyles, e datëlindjes 10.3.1952, lindur dhe banuese në Devoll, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier shpalljen të vdekur të babait të saj, shtetasit Rahmi Como.

**Kërkuesja**
Admira Bezo (Como)

**KËRKESË**

Shtetasit Agim Dollaku dhe Lutfim Dollaku, fëmijët e Sadikut dhe të Sabies, të lindur dhe banues në Durrës, kërkojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të shtetasit Luan Dollaku.

**Kërkuesit**
Agim Dollaku dhe Lutfim Dollaku

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare**
**ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.4.2012
Doli nga shtypi më 2.5.2012

| | |
|---|---|
| | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë